



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Tiranë më, 3.09.2019

Dokument parlamentar

RAPORT

PËR DEKRETIN NR. 11235, DATË 23.07.2019, TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËR “KTHIMIN E LIGJIT NR. 42/2019 “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 107/2014, “PËR PLANIFIKIMIN DHE ZHVILLIMIN E TERRITORIT”, TË NDRYSHUAR”

- Hyrje

Me dekretin nr. 11235, datë 23.07.2019, Presidenti i Republikës ka kthyer për rishqyrtim në Kuvend ligjin nr. 42/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar”.

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar”, është një propozim i Këshillit të Ministrave, i cili është shqyrtuar, në cilësinë e komisionit përgjegjës, nga Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, në mbledhjen e datës 2 korrik 2019.

Ky projektligj është shqyrtuar me procedurë të përshpejtuar, bazuar në vendimin 73, datë 20.6.2019 të Kuvendit të Shqipërisë.

Ligji 42/2019 është miratuar nga Kuvendi në seancën plenare të datës 4 korrik 2019.

- DISKUTIMI I DEKRETIT TË PRESIDENTIT NË KOMISIONIN PËR VEPRIMTARITË PRODHUESE, TREGTINË DHE MJEDISIN

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, në zbatim të nenit 86 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e komisionit përgjegjës, shqyrtoi dekretin nr. 11235, datë 23.07.2019, e Presidentit të Republikës, “Për kthimin e ligjit nr. 42/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar”, në mbledhjen e datës 3 shtator 2019.

Komisioni caktoi deputeten Eglantina Gjermani relatore për dekretin.

Të pranishëm në mbledhjen e Komisionit ishin përfaqësues të ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit.

Arsyet e kthimit të ligjit nga Presidenti i Republikës u prezantuan në mënyrë të përmbledhur nga relatorja, si vijon:

- Në dekretin e Tij, Presidenti i kërkon Kuvendit rishikimin dhe përmirësimin e nenit 8 të ligjit, pasi çmon se ai është jo i plotë dhe i paqartë në formulim, dhe si i tillë, mund të sjellë aplikim të gabuar në praktikë, apo keqinterpretim, me pasojë cenimin e parimit kushtetues të sigurisë juridike dhe të interesit publik.

Presidenti arsyeton se rishikimi i kushteve të lejes së ndërtimit dhe i projektit të zbatimit pa dijeninë dhe pëlqimin e pronarëve të pasurisë pronë private, mbi të cilin realizohet ndërtimi, nëse do të aplikoheshin në një sipërmarrje private, do të përbënin cenim të parimit të sigurisë juridike. Paqartësia dhe mungesa e rregullimit prej ligjit mbi ruajtjen dhe respektimin e të drejtave të fituara, të cilat mund të preken nga ndryshimi i projekteve fillestare, si dhe mosparashikimi në ligj i detyrimit të sipërmarrësit dhe investitorit për të njoftuar pronarin e pasurisë pronë private përpara ndryshimit të kushteve dhe projekteve të miratuara në pronën e tij, **përbën cenim të parimit të sigurisë juridike.**

Lidhur me këtë arsyetim të Presidentit, relatorja u shpreh se:

Së pari, ndryshimet që Kuvendi ka miratuar në nenin 8, “Rishikimi i kushteve të lejes”, të ligjit 42/2019, lidhen me saktësimin e termave “kushtet e lejes” dhe “projekti zbatimit”, me qëllim harmonizimin e tyre me përcaktimet e VKM nr. 408, datë 13.5.2015” Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, nenin 17 të saj, dhe nuk synojnë bërjen e ndryshimeve në thelbin e nenit 48 të ligjit 107.2014.

Mundësia e rishikimit të tyre nga autoriteti që e ka miratuar lejen, mbi kërkesën e arsyetuar të subjektit të pajisur me leje ndërtimi, është aktualisht e parashikuar nga neni 48 i ligjit, në pikën 2 të tij, e pandryshuar, që në kohën e miratimit të këtij ligji në vitin 2014. Madje mund të thuhet se kjo dispozitë e ka kaluar edhe testin e kushtetueshmërisë, për sa kohë që nuk është goditur në Gjykatën Kushtetuese.

Së dyti, në rastin e aplikimit të këtij procesi brenda një sipërmarrjeje private, siç arsyetohet në dekretin e Presidentit, rregullimi i marrëdhënies private juridiko-civile midis pronarit/ve të truallit dhe investitorit bëhet bazuar në parimin e lirisë kontraktuale, e cila përfshin edhe të drejtën e tyre për ta rishikuar marrëveshjen e bashkëpunimit të lidhur mes tyre, në rast se ndryshojnë kushtet. Për këtë arsye, shprehja e vullnetit të pronarëve të truallit, jo domosdoshmërisht duhet të jetë pjesë e parashikimeve ligjore, por mund të jetë e parashikuar, si kërkesë, në rregulloren e zhvillimit të parashikuar në pikën 3 të këtij neni.

Për këto arsye, konstatohet se pretendimi i Presidentit nuk është i bazuar.

- Në dekret, Presidenti shprehet edhe lidhur me procedurën e propozimit dhe miratimit të projektligjit nga KM, për sa i përket procesit të konsultimit publik me ministrinë e linjës apo grupet e interesit, duke arsyetuar se Kuvendi i Shqipërisë, si institucion që duhet të ushtrojë kontroll dhe mbikëqyrje ndaj veprimtarisë ekzekutive kishte për detyrë të verifikonte nëse Këshilli i Ministrave

kishte respektuar ose jo, zbatimin e ligjit në procesin e konsultimit publik dhe bashkërendimit institucional, gjë të cilën nuk e ka bërë, por e ka shqyrtuar projektligjin me procedurë të përshpejtuar.

Lidhur me këtë problematikë të sjellë nga Presidenti, relatorja u shpreh se kryerja e konsultimit publik është një çështje që është diskutuar gjatë shqyrtimit të projektligjit në Komision. Megjithatë, përfaqësuesit e ministrisë shpjeguan edhe njëherë përpara deputetëve se ministria propozuese, nëpërmjet sistemit e-akte, e ka dërguar projektligjin për mendim në ministrinë linjës, duke respektuar përcaktimet e ligjit 9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, për bashkërendimin e detyrueshëm të akteve.

Në përfundim, duke vlerësuar se argumentet e paraqitura në Dekretin nr. 11235, datë 23.07.2019, të Presidentit të Republikës, nuk kanë asnjë bazë kushtetuese dhe duke vlerësuar se neni i kontestuar është hartuar qartë dhe në përputhje harmonike me gjithë dispozitat e tjera të ligjit dhe të akteve nënligjore, relatorja ftoi anëtarët e Komisionit që të votojnë kundër Dekretit të Presidentit.

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni, me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm, vendosi **rrëzimin e Dekretit** të Presidentit të Republikës, nr. 11235, datë 23.07.2019, “Për “kthimin e ligjit nr. 42/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar” dhe ia përcjell për votim seancës plenare.

RELATORE

KRYETAR

Eglantina GJERMENI

Niko PELESHI